



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:241432
Datë: 13.06.2024
Numri i dokumentit: 05820617

C.nr.702/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike të paditësve E.K, nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit, B.M, G.M, D.K, Sh.D-K, dhe N.K, që të gjithë nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, mësimdhënës në SH.F.M.U. “Heronjtë e Kosovës” në fshatin Hoçë e Vogël, Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar avokati S.M, nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.O, avokat në Prishtinë, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 4,251.23 euro, jashtë seance me datë 13.06.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve E.K, nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit, B.M, G.M, D.K, Sh.D-K, dhe N.K, që të gjithë nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit B.M, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë:

1. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro,
2. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro,
3. për periudhën kohore Janar-Tetor 2022 në shumën prej 488,36 euro, në shumën e përgjithshme prej 670.22 €, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 17.11.2022, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses G.M, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë:

1. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro,
2. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro,
3. për periudhën kohore Janar-Tetor 2022 në shumën prej 488,36 euro, në shumën e përgjithshme prej 670.22 €, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 17.11.2022, deri në pagesën definitive, të gjitha

këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit D.K, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë:

1. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro,
2. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro,
3. për periudhën kohore Janar-Tetor 2022 në shumën prej 488,36 euro, në shumën e përgjithshme prej 670.22 €, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 17.11.2022, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses Sh.D-K, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë:

1. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 në shumën prej 7.86 euro,
2. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021 në shumën prej 133.64 euro,
3. për periudhën kohore Janar-Tetor 2022 në shumën prej 376,70 euro, në shumën e përgjithshme prej 518.20 €, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 17.11.2022, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

VI. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit N.K, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë:

1. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro,
2. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro,
3. për periudhën kohore Janar-Tetor 2022 në shumën prej 488,36 euro, në shumën e përgjithshme prej 670.22 €, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 17.11.2022, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

VII. HEDHET POSHTË si e palejueshme pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses E.K, nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit, që në emër të kompenzimit për përçindjen e shkallës së inflacionit sipas ASK-së, për vitin 2020, t’ia paguaj shumën prej 10.92, për vitin 2021 t’ia paguaj shumën prej 185.68 Euro, për periudhën kohore nga data 01.01.2022 e deri me datën 31.10.2022, për 10 muaj, t’ia paguaj shumën prej 523.36 €, gjithsej shumën e përgjithshme në emër të kompenzimit prej 719.96 €, për shkak të çështjes së gjykuar - res iudicata.

VIII. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit të dytë B.M për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 670.22 euro e deri në shumën prej 768.16 euro dhe atë për shumën prej 97.94 euro. Paditëses së tretë G.M për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 670.22 euro e deri në shumën prej 770.97 euro dhe atë për shumën prej 100.75 euro. Paditësit të katërt D.K për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 670.22 euro e deri në shumën prej 717.12 euro dhe atë për shumën prej 46.90 euro. Paditësit të gjashtë N.K për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 670.22 euro e deri në shumën prej 756.82 euro dhe atë për shumën prej 86.60 euro.

IX. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve ti paguaj shumën prej 333.00 €, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

X. Refuzohet kërkesa për kompensimin e shpenzimeve procedurale mbi shumën e aprovuar si në pikën IX të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësit E.K, nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit, B.M, G.M, D.K, Sh.D-K, dhe N.K, që të gjithë nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, në këtë gjykatë me datë 17.11.2022, përmes të autorizuarit të tyre S.M, avokat në Prizren, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, të nënshkruar me datë 18.04.2017 dhe 10.11.2022 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, punonjësve të arsimit në Kosovë i njihet e drejta e kompensimit mbi bazën e inflacionit vjetor, të iu paguhen të ardhurat sipas rritjes ekonomike të inflacionit vjetor. I autorizuari i paditëses përmes parashtrësës së datës 26.12.2023 ka precizuar kërkesëpadinë duke kërkuar nga gjykata që ta detyroi të paditurën që paditësve: 1. E.K nga fshati Xërxë, komuna e Rahovecit, në emër të kompenzimit për përqindjen(%) e shkallës së inflacionit sipas ASK-së, për vitin 2020, t'ia paguajë shumën prej 10.92 Euro, për vitin 2021, t'ia paguajë shumën prej 185.68 Euro, për periudhën kohore nga data 01.01.2022 e deri me datën 31.10.2022, për 10 muaj, t'ia paguajë shumën prej 523.36 Euro, gjithsej në shumën e përgjithshme në emër të kompenzimit prej 719.96 Euro(Shtatëqind e nëntëmbëdhjetë euro e nëntëdhjetë e gashhtë cent). 2. B.M nga fshati Drenoc, komuna e Rahovecit, në emër të kompenzimit për përqindjen(%) e shkallës së inflacionit sipas ASK-së, për vitin 2020, t'ia paguajë shumën prej 11.65 Euro, për vitin 2021, t'ia paguajë shumën prej 198.11 Euro, për periudhën kohore nga data 01.01.2022 e deri me datën 31.10.2022, për 10 muaj, t'ia paguajë shumën prej 558.40 Euro gjithsej në shumën e përgjithshme në emër të kompenzimit prej 768.16 Euro (Shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë euro e gjashtëmbëdhjetë cent). 3.G.Mnga fshati Drenoc, komuna e Rahovecit, në emër të kompenzimit për përqindjen(%) e shkallës së inflacionit sipas ASK-së, për vitin 2020, t'ia paguajë shumën prej 11.69 Euro, për vitin 2021, t'ia paguajë shumën prej 198.83 Euro, për periudhën kohore nga data 01.01.2022 e deri me datën 31.10.2022, për 10 muaj, t'ia paguajë shumën prej 560.45 Euro, gjithsej në shumën e përgjithshme në emër të kompenzimit prej 770.97 Euro(Shtatëqind e shtatëdhjetë euro e nëntëdhjetë e shtatë cent). 4.D.K nga fshati Drenoc, komuna e Rahovecit, në emër të kompenzimit për përqindjen(%) e shkallës së inflacionit sipas ASK-së, për vitin 2020, t'ia paguajë shumën prej 10.87 Euro, për vitin 2021, t'ia paguajë shumën prej 184.95 Euro, për periudhën kohore nga data 01.01.2022 e deri me datën 31.10.2022, për 10 muaj, t'ia paguajë shumën prej 521.30 Euro, gjithsej në shumën e përgjithshme në emër të kompenzimit prej 717.12 Euro(Shtatëqind e shtatëmbëdhjetë euro dymbëdhjetë cent). 5.Shkurte Daka-Krasniqi nga fshati Drenoc, komuna e Rahovecit, në emër të kompenzimit për përqindjen(%) e shkallës së inflacionit sipas ASK-së, për vitin 2020, t'ia paguajë shumën prej 7.86 Euro, për vitin 2021, t'ia paguajë shumën prej 133.64 Euro, për periudhën kohore nga data 01.01.2022 e deri me datën 31.10.2022, për 10 muaj, t'ia paguajë

shumën prej 376.70 Euro, gjithsej në shumën e përgjithshme në emër të kompenzimit prej 518.20 Euro (Pesëqind e tetëmbëdhjete euro e njëzet cent). 6.N.K nga fshati Drenoc, komuna e Rahovecit, në emër të kompenzimit për përqindjen(%) e shkallës së inflacionit sipas ASK-së, për vitin 2020, t'ia paguajë shumën prej 11.48 Euro, për vitin 2021, t'ia paguajë shumën prej 195.18 Euro, për periudhën kohore nga data 01.01.2022 e deri me datën 31.10.2022, për 10 muaj, t'ia paguajë shumën prej 550.16 Euro, gjithsej në shumën e përgjithshme në emër të kompenzimit prej 756.82 Euro(Shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro e tetëdhjetë e dy cent). Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 645.00 €.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit së saj B.O, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 03.06.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar, ndërsa e drejta për kompensim mbi bazën në të cilën janë thirrur palët paditëse nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore. Paditësit kanë ushtruar padi në gjykatë më 10.11.2022, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e përqindjes së inflacionit, për periudhën kohore 2020 – 31.10.2022, me mbështetje në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021. Kërkesëpadinë e paditësve e konteston në tërësi edhe mbi bazën që më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Paditësja E.K me aktgjykim të kësaj gjykate me nr. C.nr.213/2022, me numër të SMIL-it, 2022:071818, të datës 19.12.2023, është kompensuar në emër të inflacionit vjetor, për periudhën kohore Janar – Dhjetor 2019, Janar – Dhjetor 2020, Janar – Dhjetor 2021, dhe Janar – Shtator 2022. Andaj paditëses ti refuzohet kërkesa për kompensimin e Inflacionit vjetor për periudhën 2020 – 2022, meqenëse e njëjta është kompensuar, më tutje si në aktgjykim. Gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësit i kanë shtjerrur të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Në këtë rast paditësit nuk kanë parashtruar kërkesë për kompensim pranë të paditurës. Andaj, e konteston kërkesëpadinë e paditësit pasi që i mungon legjitimiteti real-pasiv për faktin se komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin, autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushqimin e delegimit. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës për paditësit të lëshuar nga Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësja E.K është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “Heronjtë e Kosovës” në fshatin Hoçë e Vogël, Komuna e Rahovecit. Komuna e Rahovecit, si mësimdhënës të ciklit të ulët. Ndërsa paditësit B.M, G.M, D.K, Sh.D-K, dhe N.K, janë në marrëdhënie të punës tek e paditura në shkollën “Vëllezërit Frashëri” në fshatin Drenoc, Komuna e Rahovecit. Komuna e Rahovecit, si mësimdhënës të ciklit të ulët

Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës të datës 28.02.2022 vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësve B.M, G.M, D.K, Sh.D-K, dhe N.K e që është shuma prej 421.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për paditësit B.M, G.M, D.K, dhe N.K dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.10 euro ($421 \cdot 0.2\% = 0.84 \cdot 12 = 10.10$)
- Për periudhën Janar-Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.76 euro ($421 \cdot 3.4\% = 14.31 \cdot 12 = 171.76$).
- Për periudhën Janar-Tetor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 455.80 euro ($421 \cdot 11.6\% = 48.83 \cdot 10 = 488.36$).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 152 të LPK-së ku parashihet që *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe*

147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (datë e parashtrimit të padisë), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata në këtë çështje kontestimore ka vërtetuar faktin se paditësja Sh.D-K kishte pagën bazë në shumë prej 421.00 euro, fakti i vërtetuar sipas listës së pagës së paditëses. Paditësja në kërkesëpadinë e precizuar ka kërkuar në bazë të pagës neto në shumën 327.57 euro. Në Ligjin për Procedurën Kontestimore neni 2 par. 1 përcaktohet “Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”. Mirëpo, në rastin konkret paditësja sipas kërkesëpadisë ka kërkuar kompensimin në emër të inflacionit shumën si në aktgjykim, ndërsa kjo kërkesë e saj është brenda kufijve të kërkesës, gjykata ka vendosur si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vendosur si në pikën VII. që ta hedhë poshtë si të palejueshme kërkesëpadinë e paditëses E.K lidhur me kompenzimit për përqindjen e shkallës së inflacionit sipas ASK-së, për vitin 2020, t’ia paguaj shumën prej 10.92, për vitin 2021 t’ia paguaj shumën prej 185.68 Euro, për periudhën kohore nga data 01.01.2022 e deri me datën 31.10.2022, për 10 muaj, t’ia paguaj shumën prej 523.36 €, gjithsej shumën e përgjithshme në emër të kompenzimit prej 719.96 €, pasi që ka vërtetuar faktin se me aktgjykimin e kësaj gjykate me numër C.nr.213/2022 të datës 19.12.2023, paditëses E.K i është njohur e drejta e kompenzimit për periudhën kohore janar – dhjetor 2019 në shumën prej 136.32 euro, për periudhën kohore janar – dhjetor 2020 në shumën prej 10.08 euro, për periudhën kohore janar – dhjetor 2021 në shumën prej 171.72 euro, për periudhën kohore janar – shtator 2022 në shumën prej 439.52 euro, në shumën e përgjithshme prej 757.64 euro. Kjo gjykatë kërkesëpadinë e paditëses për përqindjen e shkallës së inflacionit, e ka hedhur si të palejueshme duke u bazuar në nenin 391 pika d) të LPK-së sipas të cilit parashihet që “Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: d) çështja është gjë e gjykuar (res iudicata)”.

Gjykata ka vendosur ta refuzojë si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë si në pikën VIII. të dispozitivit paditësit të dytë B.M për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 670.22 euro e deri në shumën prej 768.16 euro dhe atë për shumën prej 97.94 euro. Paditëses së tretë G.M për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 670.22 euro e deri në shumën prej 770.97 euro dhe atë për shumën prej 100.75 euro. Paditësit të katërt D.K për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 670.22 euro e deri në shumën prej 717.12 euro dhe atë për shumën prej 46.90 euro. Paditësit të gjashtë N.K për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 670.22 euro e deri në shumën prej 756.82 euro dhe atë për shumën prej 86.60 euro, pasi që gjykata vlerëson se në rastin konkret bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve” ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve i takon e

drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duhet të llogaritet në bazë të pagës bazë 421.00 €, e jo siç kanë kërkuar paditësit në bazë të pagës neto për paditësit.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritot.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”*, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqësore, duke vendosur që e paditura t’ia kompensojë paditësve shumën si në pikën IX të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 333.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 312.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 21.00 euro.

Gjykata ka vendosur si në pikën X të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me arsyetimin se shpenzimet tjera për përpilimin e parashtresave të kërkuara nuk hyjnë në shpenzimet e shkaktuara gjatë procedurës gjyqësore konform nenit 452 të LPK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil

C.nr.702/2022, më datën 13.06.2024

Bashkëpunëtor profesional
Armond Omega

Gjyqtari
Betim Behluli

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.